



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK.nr.416/2021
Datë: 29 dhjetor 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1.24 dhe nenin 34 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 24 paragrafi 2 dhe nenit 30 të Rregullores Nr. 03/2020 mbi Organizmin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në takimin 274-të, të mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi për Strukturën Organizative (“Organogramin”) të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sipas këtij organizimi funksional:
 - 1.1. Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit;
 - 1.2. Njësia për Burime Njerëzore;
 - 1.3. Zyra për Integritet Evropian;
 - 1.4. Zyra Qendrore për Evidencë Penale;
 - 1.5. Zyra për Përkthime;
 - 1.6. Departamenti për Teknologji Informativ;
 - 1.7. Departamenti për Logjistikë dhe Infrastrukturë;
 - 1.8. Departamenti për Çështje Ligjore;
 - 1.9. Departamenti për Buxhet dhe Financa; dhe
 - 1.10. Departamenti për Prokurim.
 - 1.1.1. Sekretariati i Këshillit Gjyqësor udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili bazuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor është Zyrtari kryesor administrativ. Në kuadër të Zyrës së Drejtorit është Certifikuesi dhe Zyrtari Ligjor.
 - 1.2.1. Njësia për Burime Njerëzore udhëhiqet nga Udhëheqësi i Njesisë i cili i përgjigjet dhe i raporton drejtpërdrejtë Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit;
 - 1.2.1.1. të punësuarit në Njësi i përgjigjen dhe i raportojnë drejtpërdrejtë udhëheqësit të Njesisë.
 - 1.3.1. Zyra për Integritet Evropian udhëhiqet nga Udhëheqësi i Zyrës, i cili i përgjigjet dhe i raporton drejtpërdrejtë Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit;
 - 1.3.1.1. të punësuarit në Zyrë i përgjigjen dhe i raportojnë drejtpërdrejtë udhëheqësit të Zyrës.

- 1.4.1. Zyra Qendrore për Evidencë Penale udhëhiqet nga Udhëheqësi i Zyrës, i cili i përgjigjet dhe i raporton drejtpërdrejtë Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit;
- 1.4.1.1. të punësuarit në Zyrë i përgjigjen dhe i raportojnë drejtpërdrejtë udhëheqësit të Zyrës.
- 1.5.1. Zyra për Përkttime udhëhiqet nga Udhëheqësi i Zyrës, i cili i përgjigjet dhe i raporton drejtpërdrejtë Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit;
- 1.5.1.1. të punësuarit në Zyrë i përgjigjen dhe i raportojnë drejtpërdrejtë udhëheqësit të Zyrës.
- 1.6.1. Departamenti për Teknologji Informativë, organizohet në dy (2) Divizione, dhe atë:
- Divizioni për Infrastrukturë të Teknologjisë Informativë dhe
 - Divizioni për Aplikacione.
- Departamenti udhëhiqet nga Drejtori i Departamentit i cili i përgjigjet dhe i raporton drejtpërdrejtë Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit.
- 1.6.1.1. Udhëheqësit e divizioneve i përgjigjen dhe i raportojnë drejtpërdrejtë Drejtorit të Departamentit, ndërsa të punësuarit në divizione i përgjigjen dhe i raportojnë drejtpërdrejtë udhëheqësve të divizioneve.
- 1.7.1. Departamenti për Logjistikë dhe Infrastrukturë, organizohet në tri (3) Divizione, dhe atë:
- Divizioni për Transport dhe Siguri;
 - Divizioni për Infrastrukturë dhe Furnizime; dhe
 - Divizioni për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv.
- Departamenti udhëhiqet nga Drejtori i Departamentit i cili i përgjigjet dhe i raporton drejtpërdrejtë Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit.
- 1.7.1.1. Udhëheqësit e divizioneve i përgjigjen dhe i raportojnë drejtpërdrejtë Drejtorit të Departamentit, ndërsa të punësuarit në divizione i përgjigjen dhe i raportojnë drejtpërdrejtë udhëheqësve të divizioneve.
- 1.8.1. Departamenti për Çështje Ligjore organizohet në dy (2) Divizione, dhe atë:
- Divizioni për Mbështetje të KGJK-së, Komisioneve dhe Paneleve; dhe
 - Divizioni për Mbikëqyrje të Zbatimit të Akteve të KGJK-së dhe për Përfaqësim Gjyqësor.
- Departamenti udhëhiqet nga Drejtori i Departamentit i cili i përgjigjet dhe i raporton drejtpërdrejtë Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit.
- 1.8.1.1. Udhëheqësit e divizioneve i përgjigjen dhe i raportojnë drejtpërdrejtë Drejtorit të Departamentit, ndërsa të punësuarit në divizione i përgjigjen dhe i raportojnë drejtpërdrejtë udhëheqësve të divizioneve.
- 1.9.1. Departamenti për Buxhet dhe Financa, organizohet në dy (2) Divizione, dhe atë:
- Divizioni për të Hyra dhe Pasuri; dhe
 - Divizioni për Buxhet dhe Financa.
- Departamenti udhëhiqet nga Drejtori i Departamentit i cili i përgjigjet dhe i raporton drejtpërdrejtë Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit.
- 1.9.1.1. Udhëheqësit e divizioneve i përgjigjen dhe i raportojnë drejtpërdrejtë Drejtorit të Departamentit, ndërsa të punësuarit në divizione i përgjigjen dhe i raportojnë drejtpërdrejtë udhëheqësve të divizioneve.


1.10.1. Departamenti për Prokurim, organizohet në një (1) Divizion, dhe atë:

- Divizioni për Menaxhim të Kontratave dhe Tenderë

Departamenti udhëhiqet nga Drejtori i Departamentit i cili i përgjigjet dhe i raporton drejtpërdrejtë Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit.


1.10.1.1. Udhëheqësi i Divizionit i përgjigjet dhe i raporton drejtpërdrejtë Drejtorit të Departamentit, ndërsa të punësuarit në divizion i përgjigjen dhe i raportojnë drejtpërdrejtë udhëheqësit të divizionit.

2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është skema organizative, përkatësisht organogrami i Sekretariatit.
3. Obligohet Komisioni për Çështje Normative që jo me vonë së tre (3) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të sjell për miratim në Këshill Rregulloren për Strukturën Organizative të Sekretariatit.
4. Obligohet Drejtori i Sekretariatit që të ndërmerr veprimet e duhura për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor.


Albert Zogaj,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit t'i dërgohet:

- Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së;
- Arkivit të KGJK-së.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 14 të Rregullores Nr. 03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 50 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me datë 31 janar 2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Përmirësohet paragrafi I, pika 1.2 dhe 1.2.1 të vendimit KGJK.nr.416/2021, të datës 29 dhjetor 2021, ashtu që në vend të Njësia për Burime Njerëzore, duhet të jetë Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, konform organogramit për Strukturën Organizative të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa pjesa tjetër e vendimit mbetet e njëjtë.
- II. Vendimi hyn në fuqi më datë 31 janar 2022.

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.